



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2022:236313
Datë: 09.08.2023
Numri i dokumentit: 04569640

C-IV.-14-7543

Ankuesi:

S Sh nga Kaçaniku

Kundër

Pala kundërshtare:

N.SH “PMN Sharr”, e përfaqësuar nga **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, lagja Lakrishtë rruga “Dritan Hoxha” nr. 55, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtari Shkelzen Sylaj, me 09 gusht 2023, lëshon këtë:

A K T G J Y K I M

- I. REFUZOHET ankesa si e pabazuar dhe VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit nr.GJI042-2926 dt.21 nëntor 2014, si i drejtë dhe i bazuar në ligj.**
- II. Secila palë i bart shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 17 dhjetor 2014, ankuesi parashtroj ankesë - kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (shkurt AL) nr.GJI042-2926, të dt.21 nëntor 2014, me të cilin i ishte refuzuar kërkesa për kompensim të pagave të pa paguara në shumë prej 4,900.00 €, si dhe pronësi të aksioneve 30% në shumë prej 10,583.31 € nga N.SH “PMN Sharr” (në likuidim). Ankuesi pohoi se e kundërshton vendimin e atakuar të AL-së dhe se ndërmarrja “Sharr” e ka bërë ndryshimin e statutit të saj me dt.12.06.1991 në bazë të dispozitave ligjore gjatë viteve 1991, dhe Gjykata Ekonomike në Prishtinë me aktvendimin e plotfuqishëm FI878/91 dt.12.06.1991 ka bërë transformimin e kësaj ndërmarrje në shoqëri aksionare. Ka shtuar se forma e privatizimit këtë vit ishte antiligjore, pa tender, pa spin off special dhe pa asnjë bazë ligjore dhe aq rëndë u shkelen të drejtat e punëtorëve të NSH “Sharr”, duke mos llogaritur fare punëtorët e ish k “SH” nga H i E prej qershorit të vitit 1989 e deri në vitin 1991 kishin një status të veçantë (të garantuar me ligj) dhe kishin mbi 33% aksionet e paguara nga vet kontributet.

Bashkë me ankesën ankuesi i ka bashkëngjitur: Kopjen e vendimit të atakuar.

Me 23 dhjetor 2020, e paditura në mbrojtjen e saj të parashtuar ndaj ankesës, pohoi se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore janë zbatuar saktësisht. E paditura pohoi se kërkesa ka të bëjë me pagat e pa paguara në shumë prej 4,900 € dhe pronësi të aksioneve në 30% në shumë prej 10,583.31 € nga NSH "PMN Sharr". Ka shtuar se ankesa është e pa vlefshme duke u bazuar në nenin 36.2 i shtojcës së ligjit nr,04/L-034 për AKP-në. Pala kundërshtare e thekson faktin se pas vlerësimit të kërkesës informatat e ofruara ishin të pa mjaftueshme për të mundësuar përfshirjen në çfarëdo shpërndarje të ardhurave të likuidimit. AKP i dërgoj parashtuesit kërkesë për informata dhe dëshmi shtesë, por ankuesi sërish nuk e specifikoj periudhën e saktë të kërkesës apo bazën ligjore. AKP i është referuara edhe nenit 7 të LPK-së lidhur me detyrimin e të provuarit, përkatësisht barrën e provës të cilën e parasheh edhe nenin 31 i Ligjit të DHPGJS e të cilin ka detyrim ta provoj ankuesi. I ka kërkuar gjykatës që të refuzoj ankesën si të pa pranueshme dhe të pa bazuar.

Me 05 qershor 2023, gjykata lëshoj një urdhër për ankuesin nga i cili kërkoj që të paraqes prova me të cilat do të dëshmonte se NSH i ka mbetur borxh ankuesit paga të pa paguara dhe pronësi të aksioneve, ashtu siç pretendon ai.

Me 16 qershor 2023, ankuesi iu përgjigje urdhrorit të gjykatës përmes një parashtrese në të cilën ka pohuar se për shkak të gjendjes jo të mirë shëndetësore nuk është në gjendje që të siguroj prova. Si dëshmi ka bashkëngjitur raportet mjekësore.

Arsyetimi ligjor

Ankesa refuzohet si e pabazuar.

Në bazë të nenit 2 par.4 dhe nenit 77 par.1 pika 1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejme Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76 par.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtresat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese)”*, ndërsa pika 3 parasheh se *“pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë”*.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Në këtë rast gjykata gjen se mes palëve nuk është kontestues fakti se ankuesi ka ofruar shërbime për NSH-në, por mes palëve është kontestues fakti se a i ka mbetur NSH “PMN Sharr” borxh paga të pa paguara dhe pronësi të aksioneve, prandaj gjykata lëshoj urdhër për ankuesin duke i kërkuar dëshmi përkatëse. Ankuesi edhe pse iu përgjigj urdhrorit ka dështuar që të dorëzojë prova relevante në mbështetje të ankesës së tij.

Ankuesi nuk ka sjelle prova për të vërtetuar faktin nëse NSH i kishte mbetur borxh paga të pa paguara dhe pronësi të aksioneve, andaj në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim të pagave të papaguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Vetëm kopja e vendimit të atakuar të Autoritetit të Likuidimit, nuk dëshmon se N.SH ia ka mbetur borxh ankuesit paga të pa paguara dhe aksione.

Gjykata i dha mundësin ankuesit përmes dërgimit të urdhrorit, që të dorëzojë prova për mes të cilave do vërtetohej se vërtetë NSH i ka mbetur borxh paga të pa paguara dhe shumen e aksioneve të pretenduara, por ankuesi dështoj që ti dëshmonte pretendimet e tija me ankesë, andaj gjykata vendosi që ankesën e tij ta refuzoj si të pa bazuar.

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54 par.1 dhe 74 par.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

Shpenzimet gjyqësore

Në bazë të nenit 62.5 të Ligjit për Dhomën e Posaçme secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta. Ankuesi e ka paguar taksën gjyqësore në shumë prej 30 €.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

G j y q t a r i,
Shkelzen Sylaj